



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL NR. 5**  
Rrogozhinë, më 02.04.2024 ora 09 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja jashtë radhe e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.1275.Prot datë 29.03.2024, shtyrë për të nesërmen ditën e Martë ora 09:00 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i projekt-vendimit “Për një ndryshim të VKB-së Nr.34 datë 27.12.2023 ‘Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’ “.
- 3- Të ndryshme.

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Saimir Cani, Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Mitat Daja, Fatbardha Sina, Gezime Met-hasani, Alime Hoxha, Fatmira Thartori, Mukades Gixhari.

**Mungojnë :**

Lije Dedej, Sokol Gosa, Altin Tosku, Lulzim Hasa, Enver Memolla, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Erind Tosku.

**Të ftuar :**

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vaditjes.
4. Marsida Thartori - Drejtore e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik.



5. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
6. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
7. Luan Gjuzi - Përgjegjës i zyrës Juridike.
8. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
9. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

### **Drejton mbledhjen :**

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 12- Këshilltarë.

## **HAPET MBLEDHJA**

**Mukades Gixhari** . Atëherë përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, z. Saimir Cani, znj. Merilin Saraçi, znj. Besnike Coraj, z. Mitat Daja, znj Fatbardha Sina, znj. Gezime Met-hasani, znj. Alime Hoxha, znj. Fatmira Thartori dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 12-Këshilltarë.

Atëherë ju bëj me dije që në mbledhjen e fundit të këshillit bashkiak të datës 26.03.2024 u morën 4 vendime të cilat janë :

Vendim nr .12. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .13. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .14. Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për Bashkinë Rrogozhinë.

Vendim nr .15. Për miratimin e kërkesës me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli.

Këto vendime janë përcjellë për “Verifikim Ligjshmërie” Prefekti të Qarkut Tiranë dhe në ditët në vijim presim përgjigje nga ky Institucion.



Kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12 vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.*

**Mukades Gixhari** . Kalojmë në pikën e dytë, Miratim i projekt-vendimit “Për një ndryshim të VKB-së Nr.34 datë 27.12.2023 ‘Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’ “. Fjala për përgjegjësën e zyrës juridike z. Luan Gjuzi. Përhëndetje z. Luan.

**Luan Gjuzi** . Tarifa e vendosur në paketën fiskale nga zyra e urbanistikës me një tarifë që shkon për tokën bujqësore 1000 lekë. Kërkohej për të gjithë ato fermerë që do të pajisen me NIPD për të përfituar nga subvencionin e naftës të hiqet kjo tarifë tek paketa fiskale.

**Indrit Dedej** . E mira do ishte të kishim dhe paketën fiskale të shihnim kush pikë do ndryshohet se ne nuk e dimë.

**Luan Gjuzi** . Paketa fiskale vendimi juaj i paketës fiskale. Ka një tarifë për dokumentet të lëshuara nga zyra e kadastrës prej 1000 lekësh ne gjujkojmë për t’i ardhur në ndihmë fermerëve për të përfituar kontributin e naftës, shteti po i ndihmon t’i ndihmojmë edhe ne.

**Hekuran Xhani** . Me këtë projektvendim jam plotësisht dakord sepse kjo i shërben fermerëve për lehtësimin e procedurës për subvencionin e naftës në bujqësi, duke jetuar me shqetësimin e fermerëve qytetarëve tanë, përveç këtij vërtetimit ka dhe shumë procedura burokratike që nuk po i japin mundësinë fermerit të aplikojë për subvencionin e naftës. Psh kartën e identitetit njerëzit e kanë me shumë vështirësi për ta lëshuar rastet kur merren me qera janë shumica se ne nga 2 dynym kemi ndarë për frymë, tokat ato që i disponojnë i kanë të ... E para, e dyta kërkohej AMTP, njerëzit janë në Itali, tani problemi qëndron çfarë procedurash kemi ne si pushtet vendor që i kemi në dorë ne të bëjmë maksimumin për t’i lehtësuar mundësinë e aplikimit fermerëve për subvencionin e naftës. Ti je dhe juristi i bashkisë të shihet dhe ana juridike e këtyre problemeve dhe shqetësimeve që unë ngrita dhe sa më shpejt se dhe data mund të përfundojë shpejt data e aplikimit dhe shumë fermerë do na mbeten jashtë skemës së subvencionimit të naftës.  
Faleminderit.

**Luan Gjuzi** . Për procedurën që ka nuk është Bashkia Rrogozhinë administratore, kërkesat bëhen online në e-albania Bashkia Rrogozhinë ja ka lehtësuar të gjithë kërkesat dhe kërkon që dhe këtë kërkesë të ja lehtësojë për tarifën.



**Hekuran Xhani** . Tani Bashkia Rrogozhinë çdo fermer letrat i bën pranë njësisë administrative, dokumentacionin për subvencion. Atje kërkohet nga zotërinjtë që bëjnë shërbimet nëpër njësitë administrative kërkohet karta e identitetit, AMTP-ja dhe ky vërtetimi plus unë edhe nuk e ngrita pagesa e taksave të tokës. Tani duke u nisur nga situata mirë e bërë ti që Bashkia i ka lehtësuar por nuk i ka lehtësuar sepse gjithë procedurat varen nga pushteti vendor edhe në rast se ju i keni lehtësuar këtu duhet me i çuar dhe një urdhër zbatimi njësisive administrative sepse...

**Luan Gjuzi** . Ajo normalisht është pjesë e jona ajo...

**Hekuran Xhani** . Sepse shumica i kanë paguar taksat, ka dhe nga ta në pamundësi financiare për t'i paguar edhe ato automatikisht po e punojnë tokën dhe ai që nuk ka paguar duhet me e pranuar njerëzisht që janë më të varfër sepse ky është shkak që shqiptarët po ikin përditë sepse po e punojnë tokën me humbje, shkalla e subvencionimit është nën nivelin që bën rajoni pra fermerët tanë vazhdojnë punojnë me humbje. Kështu që çfarë ka në dorë pushteti vendor ne të bëjmë çmos t'i lehtësojmë procedurat të gjithë fermerëve të përfitojnë nga ky subvencion sepse është shumë pak për të përballuar konkurrencën rajonale në shitjen e prodhimit por të paktën edhe këtë pak ne t'i japim mundësi që ta përfitojnë.

**Mukades Gixhari** . z. Elton Xhani drejtori i bujqësië.

**Elton Xhani** . Duke marrë shkas nga problematika që njerëzit nuk kanë AMTP-të e tokës sepse shumica e njerëzve me thënë të drejtën janë dhe pleq dhe nuk ta japin edhe kartat e identitetit janë shumë të vështira me u marrë. Por njerëzit që marrin toka me qera duhet të jenë të pajisur me kontratë qeraje tek noteri që të mos i kenë këto probleme e para. E dyta për AMTP-në është kjo që ne po bëjmë tani për të hequr pjesën e AMTP-së dhe vendosur formularin A6 dhe unë për këtë shkak e kërkova mbledhjen e këshillit që të hiqet se është me tarifë 10 mijë lekëshe të vjetra që dhe shërbimin ta marrin gjithë fermerët nuk është se do kërkohet më AMTP-ja. Hiqet AMTP-ja vendoset formulari A6 dhe kartat e identitetit është obligim nga Ministria e Bujqësisë që të bëhet...

**Hekuran Xhani** . Ti kontratën e qerasë më fal që po të ndërpres, ne vazhdojmë të marrim me qera me marrëveshje gojore...

**Luan Gjuzi** . Jo juridike.

**Hekuran Xhani** . Realiteti shqiptar është ky ma jep këtë vit dhe vitin tjetër sepse kështu punohet



në Shqipëri nuk ta japin për tre vjet vitin tjetër ai thotë më duhet vetë. Kështu që 90% e kontratave të qerasë janë marrëveshje gojore, jo juridike me noter.

**Elton Xhani** . Duke qenë se e dimë shumë mirë që është marrëveshje gojore prandaj po bëhet dhe pjesa vetëm me kartat dhe formularin A6, tani nuk na japin AMTP-të fermerët apo pronarët e tokave, vërtetimin a6 dhe kartën e identitetit duhet ta japin. Se shumë mirë kur vjen koha për të marrë qeranë e dimë shumë mirë që vijnë të gjithë tek dera për qeratë e tokës.

**Hekuran Xhani** . Sot një precedent që unë e kam dëgjuar në mëngjes në kafe në fshatin tim. Fermeri Bujar Tufa shkon tek ish pronari i tokës... edhe i thotë unë dua pak sepse ligji më kërkon kartën e identitetit, ai i thotë fjalë për fjalë se unë vi direkt nga ky shqetësim ai i thotë unë kartën ta jap por kartën e identitetit nuk ta jap sepse e kam dokument privat sekret timin dhe ky është problemi që po trajtoj. Unë thashë e di shumë mirë zyra e bujqësisë meqë e ke trajtuar unë nuk kam qenë mbledhjen e kaluar për heqjen e këtyre burokracive por vendimi që merr këshilli i zbaton njësi administrative nëpërmjet urdhërit që nxjerr administrata e bashkisë. Pra ne këtu marrim vendime ju duhet të nxirrni urdhëra dhe zbatime dhe të përcillen pra të shkojnë fermerët, të paktën në njësinë time Lekaj ai zotëria që drejton atë njësi mos i nxjerri pengesa sepse njerëzit po shkojnë...

**Elton Xhani** . Nuk ka asnjë lloj pengese përveç kartës së identitetit dhe AMTP-ja dhe A6 janë obligim është e vendosur nga ministria e bujqësisë nuk e merr aplikimin.

**Hekuran Xhani** . Këtu është çështja e kartës së identitetit se nuk ta jep kartën.

**Elton Xhani** . Aty pastaj është çështja e qiradhënësit me qiramarrësin se nuk kemi çfarë i bëjmë aty.

**Hekuran Xhani** . E jep se jep nuk e detyron dot tani ne kemi një administratë që paguhet nga taksat e qytetarëve të kësaj bashkie, kemi agronom në çdo njësi administrative për ta bërë më real më objektiv çështjen e subvencionimit agronomi të marri hartën të shkojë të shikojë si shteti subvencionon tokën e punuar. Unë po them kam 500 dynym unë në fakt kam 100 dynym, ju shkoni verifikoni tokën që është mbjellë, kështu pastaj nuk ka abuzime dhe me skemën dhe për një javë agronomi e mbyll këtë punë.

**Indrit Dedej** . Tani sa për kartën e identitetit ai është një dokument personal, në momentin që ai nuk ta jep nuk ke të drejtë marrësh tokën. S'mund të marrësh naftën ti me një llafe goje dhe të thuash ma jep mua pa kartë, kur nuk të jap kartën do të thotë që nuk jam dakord.



**Luan Gjuzi** . Qiramarrësi ja jep qiradhënësit jo bashkisë mos e ngatërrojmë.

**Indrit Dedej** . Dakord por nuk ndërhyt dot Bashkia tek dokumenti personal.

**Hekuran Xhani** . Ministria e Bujqësisë është 6000 km larg nga realiteti i fermerit shqiptar sepse unë nuk shoh asnjë specialist të ministrisë asnjë ministër bujqësie shkon njëherë nëpër fushata politike. Por një specialist bujqësie të vijë të japë përvojë pune të vijë të merret me shqetësime nuk ka. Zyra e bujqësisë e zgjedhur nga qytetarët votues të bashkisë Rrogozhinë duhet t'i përcjelli ministrisë së bujqësisë shqetësimet që rëndojnë fermerin e Rrogozhinës. Nisi në mënyrë urgjente problemi në bashkinë Rrogozhinë është ky një, dy, tre të paktën të mos ju ngeli ju drejtojuni ministrisë. Edhe ligjërisht nuk lejohet me u dhënë.

**Silvana Aliu** . Nëse ti merr kartën ti mund të abuzosh.

**Fatmira Thartori** . Deri më datën 19 Prill një afat shumë i shkurtër të ishte deri në fund të muajit besoj si këshill bashkiak mos të jetë deri më datë 19 por të jetë deri në fund të Prillit. Po e shtyjmë ne bejmë kërkesën se ne jemi i gjithë vend rural bujqësor kështu që nuk mund të merret thjeshtë vetëm Tirana por edhe pjesët tjera. Për mendimin tim ajo karta e identitetit edhe pse jam e re edhe pleq me qenë nuk e japin kartën e identitetit duhet gjetur një mënyrë tjetër edhe njëherë plaku plaka nuk e jep.

**Alime Hoxha** . Pra i bie që tani duhet të merren dhe kartat e identitetit të familjarëve. Për tokat që merren me qera...unë ja marr tokën me qera një personi i cili nuk ka paguar taksën dhe këtë nuk e përfiton?

**Elton Xhani** . Jo jo thjeshtë fermeri ka paguar taksat e veta nuk është obligim të paguajë taksat e atij tjetrit.

**Alime Hoxha** . Atij tjetrit që ja kam marrë tokën me qera, ai nuk i ka paguar taksat a e marr?

**Elton Xhani** . Ti e merr,

**Alime Hoxha** . Duhet të marri vetëm vërtetimin që është i trajtuar me tokë.

**Elton Xhani** . Ai merr vërtetimin që i ka paguar taksat e veta.

**Alime Hoxha** . Kërkoj vërtetimin e personit tjetër që do marri me qera por nuk i jepet vërtetimi sepse thotë nuk ka paguar taksat.



**Fatmira Thartori** . Penalizohen dy individë edhe ai që do të marrë me qera edhe ai që ka tokën por nuk mundet dot të paguajë taksat.

**Alime Hoxha** . Jam dakord do i marr vërtetimin e atij personit që do marr tokën me qera nuk është këtu ai personi do shkoj ti marr vërtetimin që ai është i trajtuar me tokë bujqësore ai nuk i ka paguar taksat.

**Marsida Thartori** . Ai duhet ta parashikojë me kontratën...

**Alime Hoxha** . Nuk i ka parashikuar.

**Marsida Thartori** . Unë kam pasur një rast konkret para një jave dhe nuk ka patur i kemi thënë e kemi kaluar por i kemi thënë nuk duhet të vazhdojë më në vazhdim.

**Alime Hoxha** . Jepet apo nuk jepet?

**Marsida Thartori** . Po ja kemi dhënë po të them para një jave.

**Alime Hoxha** . Kam një rast nga praktika që nuk është dhënë prandaj po them.

**Marsida Thartori** . Ku?

**Alime Hoxha** . Në Sinaballaj.

**Marsida Thartori** . Sinaballajn nuk e di por unë pata një rast konkret javën e shkuar...

**Alime Hoxha** . Tani kur bëhet në Bashki duhet të bëhet edhe për njësitë.

**Marsida Thartori** . Është një urdhër i brendshëm për të gjithë që nuk ofrohet shërbim kush nuk ka paguar taksën është një urdhër i brendshëm.

**Alime Hoxha** . Po pra tani po dalim sërish tek kjo.

**Hekuran Xhani** . Ju keni ndonjë ligj të veçantë apo kalojnë nëpërmjet parlamentit bashkiak këtu urdhëra?

**Marsida Thartori** . Është një rregullore e brendshme.



**Hekuran Xhani** . E dyta ana juridike siç shpjegove është taman ashtu si e thua ti, realiteti shqiptar nuk e di jeton në fshat apo qytet është ndryshe këto marrëveshjet e qerave janë të gjitha gojore jo ligjore. Shumica e këtyre pronarëve që japin tokën me qera janë në Itali edhe shqip këtu në Shqipëri kanë mbetur tani moshë 60 e lart edhe disa fermerë në pamundësi për të ikur. Se politikat ekonomike vendore qëndrore 30 vjet i kanë bërë të zezën këtij vendi, vazhdojmë dhe tani në këtë këshill unë nuk marr pjesë në asnjë mbledhje në rast se një fermeri të vetëm do t'i nxirret pengesë për subvencionimin e naftës. Do të jap dorëheqjen nuk do të jem më anëtar i parlamentit vendor sepse jemi në heshtje jonë 30 vjeçare duke e çuar këtë vend që kemi mbetur 60 e përpjetë. Të ndihmojmë këto që kanë mbetur të paktën mirë ato që na ikën asnjë lloj detyrimi nga ana e bashkisë se çfarë bën qeveria le ta paguajë koston e vet.

**Marsida Thartori** . Ne prandaj po e kërkojmë që të lehtësojmë të gjithë procedurat për fermerët, meqenëse koha është e ngjeshur, t'i lehtësojmë këto procedura dhe pastaj kush është debitor ndaj bashkisë, ta zgjidhi më pas me rrugë të tjera.

**Hekuran Xhani** . Epo t'i mbyllim prapa mos t'i nxjerrim pengesë. Përcillini këto urdhëra administrativë se në Lekaj po i përzënë njerëzit, s'ke paguar taksat ik, s'ke kartë ik. Ata nuk dinë me lexuar e dini ku është niveli i administratës sot apo jo? Këtu truri iku nuk dinë as me lexuar , çoni urdhër me shkrim mos i nxirret urdhër dhe të mbajë përgjegjësi ai punonjës administrate që nuk zbaton urdhërin e kryetarit se përndryshe po kthehen njerëzit mbrapsh.

**Indrit Dedej** . Unë desha t'i drejtohem asaj të zyrës së taksave. Njësia administrative varet nga Bashkia apo jo?

**Marsida Thartori** . Para një muaji drejtorja e taksave nuk varej nga ne tani po.

**Indrit Dedej** . Ne nuk zgjidhim asgjë me uljen e kësaj takse ose heqjen e kësaj tarife. Problemi më i madh është ai që konstaton kolegia aty që po nuk ke paguar taksat nuk përfiton.

**Alime Hoxha** . Ideja është që ju të çoni një projekt apo një propozim tek të gjitha njësitë bashkiake që edhe pse nuk e kanë paguar taksën, të marrin vërtetimin vetëm për këtë rast.

**Indrit Dedej** . Deri në aplikim pastaj mbrapa paguaji. Do merrja me qera më tha Indrit ky nuk ka paguar, mirë i thashë kur të vijë të paguaj, unë 2 dynym kam të miat dhe i kam paguar.

**Alime Hoxha** . Ne kërkojmë që të marrin vërtetimin pavarësisht që nuk i kanë paguar taksat kaq, për këtë rast tjerët pastaj zgjidheni.





**Mitat Daja** . Që të mos hallakatemi kot i bie që objekti i mbledhjes sot është ndryshimi i paketës dhe ato pikat që janë tek paketa, të mos hallakatemi disa prej këtyre janë vendime qeverie që nuk i bëjmë ne, drejtoria e bujqësisë ja çon ministrisë pastaj zgjidhen bëhen...sepse këtu sot ka ardhur një projektvendim për lehtësimin e një procedure, sigurisht që ne duam që të lehtësohen të gjithë procedurat sepse kjo është më e mira por kjo nuk varet në dorën tonë si këshill bashkiak por as në dorën e bashkisë si bashki. Pra unë mendoj që ne të kthehemi aty ku e nisëm, tek miratimi i atij projektvendimit, ato që duan ta miratojnë ta miratojnë ta hedhim në votim që të mos rrimë e të hallakatemi ky është qëllimi i mbledhjes ky është objekti. Nuk ka diskutim tjetër punë taksash sepse është ...kur ishte punë taksash askush nuk e lexoi buxhetin, askush nuk foli për buxhetin. Kështu që tani buxheti ka kaluar dhe taksat janë vendosur, duhet me bërë një ndryshim dhe është për mirë do hiqen 10 mijë lekë shumë mirë, po i hiqet barra atyre fermerëve, ishalla vijne herën tjetër dhe heqim ndonjë taksë tjetër. Pra që unë them të kthehemi aty ku duhet dhe ta vazhdojmë mbledhjen ashtu si duhet.

**Indrit Dedej** . Këtu mund ta marrësh si merr taksat e biznesit në tre këste dhe këtu një farë shtyrje pas kësaj date, që fermerët të aplikojnë të gjithë. Taksa pra i ka penalizuar.

**Fatmira Thartori** . Nga gjithë problematika që vërejmë duhet një urdhëresë nga ana e drejtorisë së bujqësië nga ana e kryetarit që taksat të shtyhen për të gjithë njësitë për aplikantët.

**Alime Hoxha** . Taksat le të rrinë , ai t'i paguajë kur ka për t'i paguar thjeshtë të marrë vërtetimin që është i pajisur me tokë.

**Mukades Gixhari** . Jeni dakord për ta hedhur në votim pikën 2 të rendit të ditës? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

*-Miratohet me 12 vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Vendim nr. 16** . Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1268.Prot datë 29.03.2024 “Për një ndryshim të VKB-së Nr.34 datë 27.12.2023 ‘Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’ “, si dhe relacioni shpjegues për këtë projektvendim.

**Mukades Gixhari** . Tani jemi tek pika 3, të ndryshme. Me këto drejtorët që kemi këtu nëse keni ndonjë pyetje?

**Indrit Dedej** . Për konfliktin e 7-8 familjeve dhe për problemin e atij personit që i është djegur bari.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Mukades Gixhari** . E duam drejtorin këtu sepse na mbeti kërkesa pa u trajtuar herën e parë. Atëherë meqë nuk keni më diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

**MBYLLET MBLEDHJA**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 09 : 40<sup>oo</sup> . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 33 min ; 11 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 10 (dhjetë).

**Miratohet procesverbali :**

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**

**Sekretari i Këshillit**

**Ervis Shera**